

PSE ËSHTË AKTUALE SOT PASHTETËSIA NË SHQIPËRI?

- Persona në rrezik pashtetësie gjenden në komunitetin Rom dhe jo Rom në Shqipëri;
- Persona në rrezik pashtetësie gjenden midis emigrantëve shqiptarë që kthehen nga jashtë;
- Persona në rrezik pashtetësie gjenden midis fëmijëve që lindin në Shqipëri nga bashkëjetesa ose nga martesat fiktive;
- Personat në rrezik pashtetësie, në vecanti fëmijët, janë ende një fenomen i fshehur;
- Nuk mbahen statistika të dedikuara për personat pa shtetësi;
- Pashtetësia si një çështje e të drejtave të njeriut ka nevojë për përqasje multidisiplinare;



↪ **Indeksi Shqiptar që gjendet në linkun: (<https://index.statelessness.eu/>), është nisëm e Rrjetit Evropian për Pashtetësinë (ENS);**

↪ **Aty pasqyrohen Instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale për pashtetësinë;**

↪ **Legjislacioni vendas dhe masat mbrojtëse për të parandaluar pashtetësisë;**

↪ **E drejta e fëmijës për të patur një identitet;**

↪ **E drejta e fëmijës për të patur një shtetësi dhe për të jetuar i barabartë në shoqëri!**

NËSE JENI APO KENI KONTAKT ME PERSONA NË RREZIK PASHTETËSIE KONTAKTONI TLAS:

TEL : Cel: 069 20 93 731

**ADRESA: Blv. Bajram Curri, Pallatet Agimi,
Shk.18, Ap.322, Tiranë**

Email: tlas@tlas.org.al



Çfarë është PASHTETËSIA?



PERSONI PASHTETËSI
Nuk konsiderohet shtetas nga asnjë vend; Është përcaktuar në Nenin 1 të Konventës së vitit 1954 lidhur me Statusin e Personave pa Shtetësi; Vetëm këtyre personave mund t'i referohemi si ligjërisht pashtetësi;



- Personi pa shtetësi nuk ka lidhje ligjore me shtetin që i përket;
- Shtetësia mund të ekzistojë vetëm mes një personi dhe një shteti;
- Shtetësia jepet në bazë të vendit të lindjes së personit, shtetësisë së prindërve dhe vendqendrimit;
- Këtyre përsoneve mund t'i referohemi si "de jure statelessness" ose ligjërish pashtetësi;
- Vetëm autoritetet kompetente të vendit mund të njohin personin si pashtetësi;
- Të përcaktosh nëse një person është apo jo pashtetësi, duhet të trajtosh çështjen bazuar në dokumentat e kërkuara nga ligji;
- Çdo shtet përcakton kushtet për fitimin dhe humbjen e shtetësisë;

PERSONI PA SHTETËSI ËSHTË:

- I "padukshëm";
- Nuk identifikohet me një emër;
- Nuk gëzon asnjë të drejtë themelore;

NJË PERSON MBETET PASHTETËSI OSE NË RREZIK PASHTETËSIE KUR:

- Ka boshllëqe në legjislacione;
- Ka mungesa të masave të nevojshme mbrojtëse ;
- Ka diskriminim gjinor, etnik, fetar;
- Ka heqje arbitrare të shtetësisë;
- Ka barriera praktike dhe administrative për të kërkuar shtetësinë

PASHTETËSIA ËSHTË SHQETËSUESE SEPSE:

Për individët: Kufizon dhe mohon gëzimin e të drejtave të garantuara nga shteti;

Për familjet: Ndikon jetën bashkëshortore, njohjen e të drejtave familjare që trashëgohen nga prindi te fëmija, njohjen e atësisë, mëmësisë, prindërimin e fëmijëve, etj;

Për komunitetet: Shkakton tensione sociale, rrit varfërinë, dobëson zhvillimin ekonomik;

Për shtetet: Rrezikon përjashtimin ligjor dhe social të personit, çon në dëbime me forcë dhe rrit shkallën e konflikteve me shtetin dhe shoqërinë;

KUSH NUK ËSHTË "PERSON PA SHTETËSI"?

- Pashtetësi" nuk nënkupton mospasjen e një dokumenti identifikimi;
- "Pashtetësi" nuk është një person i cili nuk ka patur kurrë një dokument identifikimi;
- "Pashtetësi" nuk është e njëjtë me të qenit migrues i paligjshëm;
- "Pashtetësi" nuk është e njëjtë me të qenit refugjat;
- "Pashtetësia" ka të bëjë me faktin nëse një shtetësi gëzohet në të tashmen;
- "Pashtetësi" ka të bëjë me aplikimin e ligjit nga autoritetet në një rast konkret;

CILI ËSHTË INTERESI I KOMUNITETIT NDËRKOMBËTAR?

- T'i japë fund pashtetësisë;
- Të mbrojnë personat pashtetësi;

Cilat janë mjetet në dispozicion?

- Konventa e dedikuar e UN për të shmangur pashtetësinë e 1961;
- Konventa e UN për të mbrojtur personat pa shtetësi e 1954;
- Standardet ndërkombëtare, përfshirë kuadrin ligjor për të drejtat e njeriut;

